



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 13.04. 2023

Nr: 349

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT "PARTIA DEMOKRATIKE - ALEANCA PËR NDRYSHIM",
QARKU SHKODËR, Z. LODOVIK STAK HASANI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat "i", "n" e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1075/1 prot., datë 27.03.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Zef Kin Hila, i propozuar nga Partia Demokratike i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, propozuar nga koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim".

Koalicioni "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim", është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 02.03.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.07.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.04.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 410, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e

Data: 13.04.2023 Nr: 349
Ora: 12:00



Për dhënie të mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, Kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Koalicionit "Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim" Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore, Qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani

kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.04.2021.

Sipas këtij vendimi koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 5(pesë) mandate.

Rezulton se lista shumëmemërore e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr. 410, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 07 (shtatë), z. Lodovik Stak Hasani, i cili i përket Partisë Republikane Shqiptare (PR), pjesë e koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të listës shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Lodovik Stak Hasani, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 17 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Lodovik Stak Hasani, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet në zonën zgjedhore, qarku Shkodër për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Lodovik Stak Hasani.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Lodovik Stak Hasani, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Zef Kin Hila, i përket kandidatit vijues në listën shumëpartiake të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 07 (shtatë), z. Lodovik Stak Hasani.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në Kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

VENDOS:

1. Dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëpartiake të koalicionit “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI